



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1367/Prot.

Tiranë më 15.5.2023

2

VENDIM

Nr. 30, datë 04.05 2023

“Për hapjen e programit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike, në Fakultetin e Shkencave Sociale, të UT-së, për vitin akademik 2023-2024”

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 2, gërma “b”; neni 72, pika 1, neni 38, pika 1, gërma “dh”; Udhëzimin e Ministres së Arsimit dhe Sportit nr. 3, datë 15.02.2023 “Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlershme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike”, Kreu II, Udhëzimin e MASR-së Nr. 10, datë 30.03.2020 “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, Kreu I, pika 2, i ndryshuar, Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, gërmat f) dhe j) ; neni 101, si dhe në propozimin e përcjellë nga Fakulteti i Shkencave Sociale me shkresat nr. 293/1 Prot., datë 28.04.2023 dhe nr. 293/2 prot., datë 08.05.2023, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 04.052023;

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike, në Fakultetin e Shkencave Sociale të UT-së, sipas dokumentacionit bashkëlidhur, për vitin akademik 2023-2024.
2. Të miratojë formën e certifikatës për programin e formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike, në Fakultetin e Shkencave Sociale të UT-së.
3. Dokumentacioni përkatës përcillet për miratim të mëtejshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.
4. Dokumentacioni përkatës përcillet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore për regjistrimin e formës së certifikatës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
KRYETARI
Prof. Dr. Artan Hoxha